Shehu

albius

NR. 15076
Data 27.8.2012

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësor Privat**
**Zyra Përmbarimore Albius**

Nr. 2/16 Prot Tiranë, më 25.08.2012

**Lënda :** Kërkesë për shënimin në regjistër të akteve të përmbaruesit gjyqësor

**Drejtuar :** Z. Tomi KOLA
Drejtor i Përgjithshëm i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit

Tiranë

I nderuar Z. Kola,

Me aktin nr. 2/14, datë 10.08.2012 "Njoftim", Zyra Përmbarimore Albius, me Përmbarues Gjyqësor Privat Zef Macaj, urdhrit të ekzekutimit nr. 33 akti, datë 28.01.2004, të lëshuar për vendimin nr. 718,datë 03.04.2003 të Gjykatës së Rrethit Korçë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 165, datë 05.06.2003, është bërë njoftimi i fillimit të procedures së shpalljes për shitjen në ankand të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme që janë pjesë e aktiveve të kapitalit të shoqërisë, si dhe aksionet e saj, sipas nenit 567 të Kodit të Procedurës Civile, nëse nuk përmbushet detyrimi brenda afatit 10 ditor.

Gjithashtu, me shkresën nr. 2/15, datë 25.08.2012 "Njoftim", është bërë njoftimi për arritjen e marrëveshjes për caktimin e çmimit të të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme që janë pjesë e aktiveve të kapitalit të shoqërisë, si dhe aksionet e saj.

Për sa më sipër, kërkohet bashkëpunimi juaj, sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 46 të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat", të ndryshuar, për kryerjen e veprimit të shënimit në regjistër, për debitorin Shoqëria "Grumbullim Përpunim Drithi" sh. a., me NIPT: J64104045W dhe përfaqësues ligjor Z. Lavdërim Çota, të shkresave të sipërcituara, duke na njoftuar me shkresë sipas ligjit për këtë veprim.

Bashkëlidhur do të gjeni një kopje të aktin nr. 2/14, datë 10.08.2012 dhe aktin nr. 2/15, datë 25.08.2012, Zyra Përmbarimore Albius.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**PËRMBARUESI GJYQËSOR**

**ZEF MACAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ZEF GJ. MACAJ PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT

Rr. "Myslym Shyri", P. 25, Sh. 1, Ap. 4, kt. II-të
Përballë Drejtorisë së Përgjithshme të Albtelecom
Tiranë, Shqipëri

Tel. +355 4 224 2972
Cel. +355 67 32 27 078
E-mail: macaj.zef@gmail.com

albius

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësor Privat**
**Zyra Përmbarimore "albius"**

Nr. 2/14 Prot Tiranë, më 10, 08, 2012

**Lënda:** Njoftim

**Drejtuar:** Z. Lavdërim ÇOTA
Drejtor i Shoqërisë "Grumbullim Përpunim Drithi" sh. a,
Korçë

**Për dijeni:** Z. Grigor MULLA
Bulevardi "Republika", nr. 58,
Korçë

Nderuar Z. Drejtor,

Pas urdhërimit të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, për vendosjen e sekuestros konservative mbi pasuritë e paluajtshme, pasuria nr. 3/715, vol. 33, fq. 121, ZK 8561, indeks harte Ko-K-9, truall me sipërfaqe 198.9 m2, nga e cila 198.9 m2 ndërtesë dhe pasuria nr. 3/716, vol. 33, fq. 122, ZK 8561, indeks harte Ko-K-9, truall me sipërfaqe 7009 m2, nga e cila 2860 m2 ndërtesë, pjesë e aktiveve të kapitalit të shoqërisë, urdhërimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për vendosjen e sekuestros konservative mbi kapitalin e shoqërisë, për ekzekutimin e urdhrit të ekzekutimit nr. 33 akti, datë 28.01.2004, të lëshuar për vendimin nr. 718,datë 03.04.2003 të Gjykatës së Rrethit Korçë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 165, datë 05.06.2003, marrjen e përgjigjigjeve nga Bankat e Nivelit të Dytë, të cilat konfirmojnë mos pasjen e llogarive bankare në emër të shoqërisë, përmbaruesi gjyqësor është ngarkuar me ligj, neni 567 i Kodit të Procedurës Civile, të bëjë lajmërimin e debitorit se pasuritë e sekuestruara të cilat janë pjesë e aktiveve të kapitalit të shoqërisë dhe aksionet e saj do të shitet, në qoftë se brenda 10 ditëve nga ky lajmërim, ai nuk e përmbush detyrimin e tij.

Me kalimin e afatit të mësipërm, atëherë përmbaruesi gjyqësor do të fillojë procedurën e shpalljes për shitjen në ankand të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme që janë pjesë e aktiveve të kapitalit të shoqërisë, si dhe aksionet e saj.

Bashkëlidhur do të gjeni një fotokopje të shkresës nr. 13282/1 prot, datë 26.07.2012 dhe ekstraktin historik të regjistrit tregtar për të dhënat e shoqërisë`, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

**PËRMBARUESI GJYQËSOR**

**ZEF MAÇAJ**

Rr. "Myslym Shyri", P. 25, Sh. 1, Ap. 4, kati II-të
Përballë Albtelecomdhe Gjykatës së Lartë
Tiranë, Shqipëri

Tel. +355 4 224 2972
Cel. +355 67 32 27 078,
E-mail: macaj.zef@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësor Privat
Zyra Përmbarimore Albius

Nr. 2/15 Prot Tiranë, më 25.08.2012

**Lënda:** Njoftim

**Drejtuar:** Z. Lavdërim ÇOTA
Drejtor i Shoqërisë "Grumbullim Përpunim Drithi" sh. a,
Korçë

Z. Grigor MULLA
Bulevardi "Republika", nr. 58,
Korçë

Të nderuar zotërinj,

Referuar nenit 564 të Kodit të Procedurës Civile, përmbaruesi gjyqësor është i ngarkuar të bëjë njoftimin e palëve, kreditorit dhe debitorit, për arritjen e marrëveshjes për vlerën e pasurive, mbi të cilat është vendosur sekuestroja, brenda një jave (7 ditë ), dhe nëse nuk arrihet kjo marrëveshje, atëherë përmbaruesi gjyqësor, brenda 15 ditëve, përcakton me vendim vlerën e tij, bazuar në aktin e ekspertimit, të paraqitur nga një ekspert i licencuar dhe në vlerën reale të pasurisë në treg, në çastin e vënies së sekuestros mbi të.

Për këto arsye, brenda një javë nga njoftimi i kësaj shkrese, kërkohet nga ana juaj, arritja e marrëveshjes për caktimin e çmimit të të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme që janë pjesë e aktiveve të kapitalit të shoqërisë, si dhe aksionet e saj.

Në rast se nuk arrihet kjo marrëveshje, atëherë përmbaruesi gjyqësor, brenda 15 ditëve, përcakton me vendim vlerën e pasurive të mësipërme, bazuar në aktin e ekspertimit, të paraqitur nga një ekspert i licencuar dhe në vlerën reale të pasurisë në treg, në çastin e vënies së sekuestros mbi to.

Jemi në pritje të konfirmimit për kryerje e pagesën së plotë të detyrimit që rrjedh nga vendimi nr. 718,datë 03.04.2003 të Gjykatës së Rrethit Korçë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 165, datë 05.06.2003, tarifën përmbarim e shpenzimet përmbarimore dhe kalimin e këtyre shumave në llogarinë rrjedhëse në Raiffeisen Bank, IBAN: 11202110130000000000414705 ALL të Përmbaruesit Gjyqësor Privat Zef Macaj.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**PËRMBARUESI GJYQËSOR**

**ZEF MACAJ**

Rr. "Myslym Shyri", P. 25, Sh. 1, Ap. 4, kati II-të
Përballë Albtelecomdhe Gjykatës së Lartë
Tiranë, Shqipëri

Tel. +355 4 224 2972
Cel. +355 67 32 27 078,
E-mail: macaj.zef@gmail.com

Shelun lejuar!!

Te depozitet per palujshm

Gjyqi!

19411
7.11.2012

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësor Privat
Zyra Përmbarimore Albius

VENDIM

Nr. 2/19, Datë 02.11.2012

"Për caktimin e çmimit të pasurive të paluajtshme të debitorit "

Unë Zef Macaj, Përmbarues Gjyqësor Privat, pas marrjes në dorëzim të raportit të vlerësimit dhe pasqyrës financiare të aktiveve të Shoqërisë "Grumbullim Përpunim Drithi" sh. a. të vlerësuara Eksperti Vlerësues Z. Robert Bregu dhe Eksperti Kontabël i Autorizuar Z. Qani Kajo, në zbatim të urdhrit të ekzekutimit nr. 33 akti, datë 28.01.2004, të lëshuar për vendimin nr. 718, datë 03.04.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 165, datë 05.06.2003,

KONSTATOVA:

Z. Robert Bregu dhe Z. Qani Kajo, kanë përmbushur detyrën e tyre të caktuar në vendimin nr. 2/17, datë 10.09.2012, duke përcaktuar vlerën e pasurive të paluajtshme që janë pjesë e kapitalit të shoqërisë, në 100% të aksioneve të saj. Krahas vlerësimit të kapitalit të shoqërisë, ekspertët kanë individualizuar çdo pasuri të paluajtshme të saj dhe përditësimin e këtyre pasurive me hartën aktuale të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Korçë.

Meqenëse vlera e përgjithshme e pasurive të paluajtshme që janë pjesë e kapitalit të shoqërisë, është më e madhe se vlera e detyrimit që rrjedh nga vendimi nr. 718,datë 03.04.2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 165, datë 05.06.2003, sipas nenit 527 të Kodit të Procedurës Civile dhe në rast se nuk shlyhet detyrimi nga debitori brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 567 të Kodi të Procedurës Civile, do ti nënshtrohet shitjes në ankand pasuria nr. 3/716 "Magazinë 4 kate", truall me sipërfaqe prej 994 m2 dhe ndërtesë me sipërfaqe prej 3976 m2, zona kadastrale nr. 8561, Rr. "Dhimitër Drenasi", e cila është vlerësuar nga Eksperti Vlerësues Robert Bregu në vlerën **25, 899, 664 lekë.**

Në bazë të nenit 563 të Kodit të Procedurës Civile, është bërë verifikimi i dokumentacionit të pasurive të paluajtshme, të cilat janë pjesë e aktiveve të debitorit Shoqërisë "Grumbullim Përpunim Drithi" sh.a., të pasyruara edhe në pasyrën financare të vitit 2012 të administruar në dosjen përmbarimore dhe të dërguar nga debitori. Ky informacion është marrë edhe nga Zyra vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë.

Referuar nenit 564 të Kodit të Procedurës Civile, paragrafi i dytë, përmbaruesi gjyqësor, brenda 10 ditëve nga data e caktimit të vlerës, njofton kreditorin e debitorin për çmimin e caktuar dhe në bazë të nenit 568 të Kodit të Procedurës Civile, paragrafi i dytë, çmimi fillestar në ankand është 80 për qind i çmimit të përcaktuar, sipas nenit 564 të këtij ligji".

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ZEF GJ MACAJ PËRMBARUES GJYQËSOR

Për këto arsye, në mbështetje të nenit 527, 563, 564, 567 e 568 të Kodit të Procedurës Civile, nenit 32 e 46 të ligjit nr. të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat", të ndryshuar, nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar, nenit 38 të ligjit nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", si dhe udhëzimin nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementëve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit nga regjistruesit",

VENDOSA:

1. Caktimin e çmimit në shumën **20, 719, 731 (njëzet milion e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e një mijë) Lekë**, të pasurisë nr. 3/716 "Magazinë 4 kate", truall me sipërfaqe prej 994 m2 dhe ndërtesë me sipërfaqe prej 3976 m2, zona kadastrale nr. 8561, Rr. "Dhimitër Drenasi", në 80% e vlerës të përcaktuar në aktin e vlerësimit.

2. Ky vendim hartohet në 5(pesë) kopje, një kopje administrohet në dosjen përmbarimore, një kopje i njoftohet kreditorit, një kopje i njoftohet debitorit, një kopje i dërgohet për shënim në regjistër Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, si dhe një kopje i dërgohet për shënim në seksionin "E" të kartelës së pasurisë të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Kundër veprimeve të përmbaruesit mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatë. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata vendos ndryshe.

4. Raporti i vlerësimi të Ekspertit Vlerësues Z. Robert Bregu dhe Ekspertit Kontabël të Autorizuar Z. Qani Kajo, i bashkëlidhet këtij vendimi, është pjesë integrale e tij dhe i njoftohet kreditorit e debitorit.

U shpall sot më datë 02.11.2012.

**PËRMBARUESI GJYQËSOR**

**ZEF MACAJ**

Rr. "Myslym Shyri", P. 25, Sh. 1, Ap. 4, kati II-të
Përballë Albtelecom dhe Gjykatës së Lartë
Tiranë, Shqipëri

Tel. +355 4 224 2972
Cel. +355 67 32 27 078,
E-mail: macaj.zef@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësor Privat
Zyra Përmbarimore Albius

# VENDIM

Nr. 2/20, Datë 04.11.2012

"Për shpalljen e shitjes në ankand për pasuritë e paluajtshme të debitorit"

Unë Zef Macaj, Përmbarues Gjyqësor Privat, pas kalimit të afatit 10 ditor nga njoftimi i debitorit për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme që janë pjesë e aktiveve të kapitalit të Shoqërisë "Grumbullim Përpunim Drithi" sh.a., në rast mospërmbushje të detyrimit, të kryer nëpërmjet shkresës nr. 2/14, datë 10.08.2012, vlerësimit të kryer nga eksperti vlerësues Z. Robert Bregu dhe eksperti kontabël të autorizuar Z. Qani Kajo, si dhe pas caktimit të çmimit të pasurisë së paluajtshme, me vendimin nr. 2/19, datë 02.11.2012,

## KONSTATOVA:

Sipas akteve të administruara në dosje, edhe pas kalimit të afatit 10 ditor, nga njoftimi i debitorit për ekzekutimin e detyrimit të përcaktuar në titullin ekzekutiv, vendimin nr. 718, datë 03.04.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 165, datë 05.06.2003, ky detyrim nuk rezulton të jetë përmbushur nga ana e tij. Në këto kushte përmbaruesi gjyqësor, bën shpalljen për shitjen në ankand të pasurisë.

Në bazë të nenit 568 të Kodit të Procedurës Civile, shpallja për shitjen në ankand afishohet në zyrën e përmbaruesit gjyqësor dhe në vendin ku ndodhet sendi i paluajtshëm, gjykatë, komunë, bashki, njësitë bashkiake dhe në një vend apo vende të tjera publike,që ai i çmon të përshtatshme. Shpallja duhet të përmbajë emrin, atësinë dhe mbiemrin e pronarit të sendit, nëse për sendin është vënë hipotekë dhe për çfarë shume të hollash, çmimin e sendit me të cilin do të fillojë shitja, vendi, dita kur do të përfundojë shitja në ankand. Shitja nuk mund të bëhet para se të kenë kaluar 15 ditë nga shpallja e ankandit. Për shpalljen e shitjes në ankand duhet të njoftohen edhe kreditorët që kanë hipotekë.

Për këto arsye, në mbështetje të nenit 567, 568, 569 e 570 të Kodit të Procedurës Civile, nenit 32 e 46 të ligjit nr. të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat", të ndryshuar, nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar,

## VENDOSA:

1. Shpalljen e shitjes në ankand të pasurisë nr. 3/716 "Magazinë 4 kate", truall me sipërfaqe prej 994 m2 dhe ndërtesë me sipërfaqe prej 3976 m2, zona kadastrale nr. 8561, Rr. "Dhimitër Drenasi", që është pjesë e aktiveve të kapitalit të Shoqërisë "Grumbullim Përpunim Drithi" sh.a.

2. Çmimi i pasurisë të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi me të cilin do të fillojë shitja, është 20, 719, 731 (njëzet milion e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e një mijë) Lekë, sipas vendimit nr. 2/19, datë 02.11.2012 "Për caktimin e çmimit të pasurisë së paluajtshme të debitorit".

3. Çdo ofertues që merr pjesë në ankand, përpara fillimit të ankandit(deri më datë 19.11.2012, ora 16.15) duhet të depozitojë si garanci në llogarinë rrjedhëse të Përmbaruesit Gjyqësor Privat Zef Macaj, në Raiffeisen Bank, IBAN: AL 11202110130000000000414705 ALL, një shumë të hollash të barabartë me 10 % të çmimit të pasurisë të caktuar në shpallje. Kreditori nuk le garanci, në rast se kredia e tij e kalon masën e garancisë. Në ditën dhe orën e caktuar të ankandit, secili ofertues duhet të paraqitet personalisht ose përfaqësuesi i tij me prokurë dhe përpara fillimit të ankandit duhet të paraqesë faturën bankare të 10%, si dhe dokumentin e identifikimit (Kartë identiteti ose Pasaportë).

4. Shitja e pasurive do të bëhet më datë 19.11.2012 në Zyrën Përmbarimore Albius, me Përmbarues Gjyqësor Privat Zef Macaj. Ajo vazhdon 15 ditë dhe përfundon me mbarimin e orarit zyrtar të ditës së fundit (orën 16.15 e datës 19.11.2012), që tregohet në shpalljen për shitjen në ankand.

5. Nëse ofertuesi është person juridik, përveç dokumenteve të përmendura në pikën 3 të këtij vendimi, përfaqësuesi ligjor duhet të paraqesë statusin, aktin e themelimit të personit juridik, një kopje të ekstraktit të 3 muajve të fundit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe një kopje të çertifikatës së regjistrimit të tij/ saj.

6. Ky vendim hartohet në 9(nëntë) kopje, një kopje administrohet në dosjen përmbarimore, një kopje afishohet në Zyrën Përmbarimore Albius të Përmbaruesit Gjyqësor Privat Zef Macaj, një kopje shpallet në vendin ku ndodhet sendi i paluajtshëm, nga një kopje i njoftohet debitorit dhe kreditorit, një kopje i dërgohet për shpallje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, një kopje i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për shënim në regjistër, një kopje i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik për publikim në buletinin e saj, si dhe një kopje Bashkisë Korçë, për të afishuar këtë vendim në ambjentet e saj publike.

7. Debitori, përfaqësuesi i tij ligjor, përmbaruesi gjyqësor si edhe personat e tjerë që tregohen në nenin 709 të Kodit Civil, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ankand dhe kur sendi blihet nga një person që nuk ka të drejtë të marrë pjesë në ankand, shitja është e pavlefshme. Në këtë rast, shuma e lënë si garanci nga bleresi kalon në dobi të shtetit dhe sendi me kërkesë të secilit kreditor mund të shitet përsëri në ankand, duke vepruar sipas rregullave të caktuara në Kodin e Procedurës Civile.

8. Kundër veprimeve të përmbaruesit mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatë. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata vendos ndryshe.

U shpall sot në Tiranë, më datë 04.11.2012.

**PËRMBARUESI GJYQËSOR**

**ZEF MACAJ**

Rr. "Myslym Shyri", P. 25, Sh. 1, Ap. 4, kati II-të
Përballë Albtelecom dhe Gjykatës së Lartë
Tiranë, Shqipëri

Tel. +355 4 224 2972
Cel. +355 67 32 27 078,
E-mail: macaj.zef@gmail.com

Shehu

QENDRA KOMBETARE E REGJISTRIMIT
NR. 20260 Prot.
Date 22.11.2012

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësor Privat**
**Zyra Përmbarimore Albius**

# VENDIM

**Nr. 2/21, Datë 20.11.2012**

**"Për caktimin e çmimit të ankandit të dytë të shitjes së pasurive të paluajtshme të debitorit"**

Unë Zef Macaj, Përmbarues Gjyqësor Privat, pas zhvillimit të ankandit të parë, më datë 10.10.2012, për shitjen e pasurive që janë pjesë e inventarit dhe aktiveve të kapitalit të debitorit, Shoqërisë "Grumbullim Përpunim Drithi" sha.a., në zbatim të urdhrit të ekzekutimit nr. 33 akti, datë 28.01.2004, të lëshuar për vendimin nr. 718,datë 03.04.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 165, datë 05.06.2003,

## KONSTAT OVA:

Në datën dhe orën e caktuar për shitjen në ankand në vendimin nr. 2/20, datë 04.11.2012"Për shpalljen e shitjes në ankand për pasuritë e paluajtshme të debitorit", për pasurisë nr. 3/716 "Magazinë 4 kate", truall me sipërfaqe prej 994 m2 dhe ndërtesë me sipërfaqe prej 3976 m2, zona kadastrale nr. 8561, Rr. "Dhimitër Drenasi", që është pjesë e aktiveve të kapitalit të Shoqërisë "Grumbullim Përpunim Drithi" sh.a., nuk u paraqitën oferta për blerjen e saj.

Referuar nenit 577 të Kodit të Procedurës Civile, paragrafi parë, në rast se në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertë, atëherë përmbaruesi gjyqësor, brenda 10 ditëve nga përfundimi i tij, përcakton çmimin e ri të sendit, jo më të ulët se 20 për qind të çmimit fillestar të caktuar në ankandin e parë.

Për këto arsye, në mbështetje të nenit 577 të Kodit të Procedurës Civile, nenit 32 të ligjit nr. të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat", të ndryshuar,

## VENDOSA:

1. Caktimin e çmimit në shumën **16, 575, 784 (Gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër ) Lekë**, për pasurinë nr. 3/716 "Magazinë 4 kate", truall me sipërfaqe prej 994 m2 dhe ndërtesë me sipërfaqe prej 3976 m2, zona kadastrale nr. 8561, Rr. "Dhimitër Drenasi", në 20 për qind të çmimit fillestar të caktuar në ankandin e parë.

2. Ky vendim hartohet në 4(katër) kopje, një kopje administrohet në dosjen përmbarimore, një kopje Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, e cila shënon përmbajtjen e këtij aktin në ekstraktin

të shoqërisë debitore, një kopje i njoftohet kreditorit dhe një kopje i njoftohet debitorit në adresën e tyre.

3. Kundër vendimit të përmbaruesit mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatë. Ankimi kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor nuk pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata vendos ndryshe.

U shpall sot më datë 20.11.2012.

**PËRMBARUESI GJYQËSOR**

**ZEF MACAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ZEF MACAJ PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT

Rr. "Myslym Shyri", P. 25, Sh. 1, Ap. 4, kati II-të
Përballë Albtelecom dhe Gjykatës së Lartë
Tiranë, Shqipëri

Tel. +355 4 224 2972
Cel. +355 67 32 27 078,
E-mail: macaj.zef@gmail.com

QENDRA KOMBETARE E REGJISTRIMIT NR. 20466 Prot. Datë 27. 11. 2012

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësor Privat
Zyra Përmbarimore Albius

# VENDIM

Nr. 2/22, Datë 26.11.2012

"Për shpalljen e shitjes në ankandin e dytë të pasurive të paluajtshme të debitorit"

Unë Zef Macaj, Përmbarues Gjyqësor Privat, pas zhvillimit të ankandit të parë, më datë 10.10.2012, për shitjen e pasurive që janë pjesë e inventarit dhe aktiveve të kapitalit të debitorit, Shoqërisë "Grumbullim Përpunim Drithi" sh.a., në zbatim të urdhrit të ekzekutimit nr. 33 akti, datë 28.01.2004, të lëshuar për vendimin nr. 718,datë 03.04.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 165, datë 05.06.2003,

## KONSTATOVA:

Në datën dhe orën e caktuar për shitjen në ankand në vendimin nr. 2/20, datë 04.11.2012"Për shpalljen e shitjes në ankand për pasuritë e paluajtshme të debitorit", për pasurisë nr. 3/716 "Magazinë 4 kate", truall me sipërfaqe prej 994 m2 dhe ndërtesë me sipërfaqe prej 3976 m2, zona kadastrale nr. 8561, Rr. "Dhimitër Drenasi", që është pjesë e aktiveve të kapitalit të Shoqërisë "Grumbullim Përpunim Drithi" sh.a., nuk u paraqitën oferta për blerjen e saj.

Referuar nenit 577 të Kodit të Procedurës Civile, paragrafi parë, në rast se në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertë, atëherë përmbaruesi gjyqësor, brenda 10 ditëve nga përfundimi i tij, përcakton çmimin e ri të sendit, jo më të ulët se 20 për qind të çmimit fillestar të caktuar në ankandin e parë. Ankandi i dytë për shitjen e sendit zhvillohet jo më vonë se 15 ditë nga data e caktimit të çmimit të ri. Caktimi i çmimit është bërë më date 20.11.2012 dhe sot më datë 26.11.2012, brenda afatit 15 ditor, bëj shpalljen e ankandit të dytë për shitjen e pasurive të paluajtshme të debitorit Shoqëria "Grumbullim Përpunim Drithi" sh.a.

Për këto arsye, në mbështetje të nenit 568, 569, 570 e 577 të Kodit të Procedurës Civile, nenit 32 dhe 46 të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat", të ndryshuar,

## VENDOSA:

1. Shpalljen e shitjes në ankand të dytë, të pasurisë nr. 3/716 "Magazinë 4 kate", truall me sipërfaqe prej 994 m2 dhe ndërtesë me sipërfaqe prej 3976 m2, zona kadastrale nr. 8561, Rr. "Dhimitër Drenasi", që është pjesë e aktiveve të kapitalit të Shoqërisë "Grumbullim Përpunim Drithi" sh.a.

2. Çmimi i pasurisë të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi me të cilin do të fillojë shitja, është **16, 575, 784 (Gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër ) Lekë**, sipas vendimit nr. 2/21, datë 20.11.2012 " Për caktimin e çmimit të ankandit të dytë të shitjes së pasurive të paluajtshme të debitorit".

3. Çdo ofertues që merr pjesë në ankand, përpara fillimit të ankandit deri më datë 03.12.2012, ora 16.15, duhet të depozitojë si garanci në llogarinë rrjedhëse të Përmbaruesit Gjyqësor Privat Zef Macaj, në Raiffeisen Bank, IBAN: AL 11202110130000000000414705 ALL, një shumë të hollash të barabartë me 10 % **( shuma 1, 657, 578.4 lekë)** të çmimit të pasurisë të caktuar në shpallje. Kreditori nuk le garanci, në rast se kredia e tij e kalon masën e garancisë. Në ditën dhe orën e caktuar të ankandit, secili ofertues duhet të paraqitet personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesi të tij me prokurë dhe përpara fillimit të ankandit duhet të paraqesë faturën bankare të 10% **(shuma 1, 657, 578.4 lekë)**, si dhe dokumentin e identifikimit (Kartë identiteti ose Pasaportë).

4. Shitja e pasurive do të bëhet më datë 03.12.2012 në Zyrën Përmbarimore Albius, me Përmbarues Gjyqësor Privat Zef Macaj. Ajo vazhdon 15 ditë dhe përfundon me mbarimin e orarit zyrtar të ditës së fundit (orën 16.15 e datës 03.12.2012), që tregohet në shpalljen për shitjen në ankand.

5. Nëse ofertuesi është person juridik, përveç dokumenteve të përmendura në pikën 3 të këtij vendimi, përfaqësuesi ligjor duhet të paraqesë statusin, aktin e themelimit të personit juridik, një kopje të ekstraktit të 3 muajve të fundit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe një kopje të çertifikatës së regjistrimit të tij/ saj.

6. Ky vendim hartohet në 8(tetë) kopje, një kopje administrohet në dosjen përmbarimore, një kopje afishohet në ambientet e Zyrës Përmbarimore Albius, të Përmbaruesit Gjyqësor Privat Zef Macaj, një kopje shpallet në vendin ku ndodhet sendi i paluajtshëm, nga një kopje i njoftohet debitorit dhe kreditorit, një kopje i dërgohet për shpallje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, një kopje i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për shënim në regjistër, si dhe një kopje Bashkisë Korçë, për të afishuar këtë vendim në ambjentet e saj publike.

7. Debitori, përfaqësuesi i tij ligjor, përmbaruesi gjyqësor si edhe personat e tjerë që tregohen në nenin 709 të Kodit Civil, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ankand dhe kur sendi blihet nga një person që nuk ka të drejtë të marrë pjesë në ankand, shitja është e pavlefshme. Në këtë rast, shuma e lënë si garanci nga bleresi kalon në dobi të shtetit dhe sendi me kërkesë të secilit kreditor mund të shitet përsëri në ankand, duke vepruar sipas rregullave të caktuara në Kodin e Procedurës Civile.

8. Kundër veprimeve të përmbaruesit mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatë. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata vendos ndryshe.

U shpall sot në Tiranë, më datë 26.11.2012.

PËRMBARUESI GJYQËSOR

ZEF MACAJ

Rr. "Myslym Shyri", P. 25, Sh. 1, Ap. 4, kati II-të
Përballë Albtelecom dhe Gjykatës së Lartë
Tiranë, Shqipëri

Tel. +355 4 224 2972
Cel. +355 67 32 27 078,
E-mail: macaj.zef@gmail.com